



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 50**

Datë: 28. 09. 2017, ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Eshref Vishi, anëtarë i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

---

## **RENDI I DITËS**

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.46, 47 dhe 48/2017*

2.Raport i Aktiviteteve të Sekretariatit

3.Aktivitetet e SKQZ-së

4. Aktivitetet e ZRPP-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i akreditimit të vëzhguesve për zgjedhjet lokale 2017*

5. Raport i Këshillave;

- Këshilli për Operacione Zgjedhore;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i mostrave të fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme për Zgjedhjet Lokale 2017;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së emërimeve për Këshillat e Vendvotimeve sipas komunave përkatëse për Zgjedhjet Lokale 2017;*

- Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të ballinës së Ueb Faqes së KQZ-së;
- Plotësimi i grupit punues për ridizajnimin e Ueb Faqes së KQZ-së me anëtarë të KQZ-së;

6 . Të ndryshme.

---

## **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.46, 47 dhe 48/2017*

**Valdete Daka:** Faleminderit, po fillojmë me mbledhjen e 50-të të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve...Sa i përket rendit të ditës, e keni para jush këtë rend të dites...A ka ndokush, ndonjë pyetje...?

**Betim Gjoshi:** Kryetare, në pikën e “pajtimit dhe të shqyrtimit të operacioneve”, edhe në këtë pikën “mostrat e fletëvotimit”, ndoshta është më shumë një njoftim për me i tregue, i kemi shqyrtu edhe analizue...

**Adnan Rrustemi:** Kryetare, edhe unë jam dakord, është vetëm një njoftim, dhe krejt këshillat pajtohet, vetëm mbetet m’u njoftue...

**Valdete Daka:** Atëhere, e votojmë këtë rendë të ditës...!

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.*

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me pikën e pare: miratimi i procesverbalit të 46- 47 – 48...A ka dikush vërejtje për këto procesverbale...? Nëse jo, kush është për miratimin e tyre ?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalet e mbledhjeve të KQZ-së nr.46, 47 dhe 48/2017*

## **2.Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së**

**Enis Halimi:** Sekretariati ka vijë me përmbushjen e obligimeve të veta në funksion të zbatimit të procesit zgjedhor 2017, ju njoftoj se periudha e votimit përmes postës ka filluar më 22 shtator, dhe përfundon me datën 20 tetorë 2017. Pra fillimit të kësaj faze, janë pregaditë materialet për votim dhe janë dërguar përmes postës për votuesit të cilët në mënyrë të sukseshme kanë aplikuar për t’u regjistruar gjatë periudhës së aplikimit..., e që është ndërmarrë nga data 16 korrik, deri më 23 gusht 2017. Përmes postës janë dërguar zarfa për votuesit jashtë Kosovës që kanë përmbajtur fletëvotime për asamble komunale dhe kryetar komune, broshura me udhëzimet se si votohet, zarfin kthyes dhe të gjitha materialet e tjera...Numri i zarfeve që u janë dërguar votuesve jashtë Kosovës, është 10.746, po ashtu 6.500 votues janë njoftuar përmes imellit. Me qëllim të njoftimit të sa më shumë qytetarë për këtë të drejtë të tyre, ne e kemi publikuar për

nevojat e njoftimit në Ëeb faqe listën e votuesve që janë jashtë Kosovës të ndarë sipas komunave dhe në nivel republike, fletëvotimet, boshurat e kandidatëve etj. Kemi bërë edhe dërgimin e materialeve nëpër pika shpërndarëse në 26 ambasada, në 26 konsullata dhe në 31 pika shpërndarëse...

Është në vijim, tha z. Halimi periudha e regjistrimit të votuesve në institucione. Ne, kemi ndërmarrë të gjitha aktivitetet e përbushjes së obligimeve të kësaj kategorie...Kemi kontaktuar edhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për t'i marrë evidencat e atyre që janë nëpër burgje, dhe po ashtu, edhe ata që janë nëpër spitale. Për sa i përket edukimit dhe informimit, raporti për këtë fazë...ne jemi në fund të aktivitetit kur e njoftojmë publikun se si votohet edhe për afatin e dorëzimit të fletëvotimeve, dhe për këtë fazë janë duke u realizuar këto aktivitetet që janë në proces të njoftimit në shumë gjuhë, si ajo shqipe dhe serbishte dhe, informimi bëhet në portale të ndryshme, në kanal të RTK - së, në publikimi i njoftimeve të radiospotëve në kanale zyrtare edhe të KQZ-së, në rrjete sociale, në Facebook, në YouTube. Po ashtu, ne kemi vendosur edhe bashkpunim me organizata civile, dhe të gjitha materialet po i ndajmë edhe me ta...Njëkohësisht, është një aktivitet që ka të bëjë me atë se si plotësohen fletëvotimet, dhe hapat në vendvotim...I kemi dërguar njoftimet në të gjitha kanalet, dhe për shkak të mungesës së tenderit të Informimit Publik...megjithatë, ne kemi ndërmarrë aktivitete alternative që e përbushin aktivitetin dhe boshllëkun që po e shkakton niveli burokratik...Jemi duke e inicuar prodhimin e një materiali që ka të bëjë me KVV dhe sidomos, me kryesuesit e KVV-e, e që kjo ka të bëjë me një material elektronik vizuel e që do t'u shpërndahet, dhe që po përdoret për herë të parë...

Për sa i takon informimit publik, ne kemi shfrytëzuar zyrtarët tanë komunal për të vu kontakte me shoqërinë civile, me mediat lokale, me partitë politike për të sensibilizuar opinionin për rëndësinë e votimit edhe për mënyrën e votimit...Po ashtu, kemi paraparë në mbështetje të Ifesit, botimin e 800.000 fletushkave dhe që do t'u shpërndahet të gjithë atyre votuesve që do shkojnë nëpër qendra votuese, dhe se do t'u shpjegohet për mënyrën se si duhet të plotësohet fletëvotimi...Dhe gjithashtu, kemi organizuar edhe aktivitetet në disa universitete publike dhe jo publike që do të mbahen ligjeratat dhe të mbahen aktivitete informuese për mundësinë e informimit se si votohet...Edhe në QNR, po zhvillohen aktivitetet...

**Betim Gjoshi:** E para e punës, nuk është e nevojshme dhe e domosdoshme me na lexue këtë farë raporti, se është i gjatë...Ka kohë kur ne do të informohemi...Një propozim i imi lidhur me IFES-in që neve na ka mbështetë në të kaluarën...dhe unë e shfrytëzoj rastin personalisht me e falenderue këtë organizatë për ndihmën e madhe që na ka dhënë për me i informue dhe me i edukue qytetarët për procedurat e votimit dhe procedurat e tjera...Është jashtëzakonisht e mirëseardhur kjo ndihmë...Është momenti ma i duhur edhe për institucionin, por edhe për vetë procesin zgjedhorë...Mos të harrojmë se "partia e 4" edhe në zgjedhjet e kaluara, kanë qenë votuesit që nuk kanë ditur me votue...ose që i kanë pasur votat e pavleshme. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, kanë qenë 103.000 fletvotime të pavlefshme...Iu kushtua më shumë vëmendje votuesve të diasporës, e që janë nja 10.000, kurse nuk iu kushtua vëmendje votuesve këtu,

brenda që i kemi 1 milion e 800.000 dhe që nuk jemi duke bërë sa duhet, e kjo është shumë keq...

**Adnan Rrustemi:** Faliminderit, së pari, natyrisht se na jemi me një situatë pak a shumë të vështirë që mundë të themi se për herë të parë ne nuk po zhvillojmë fushatë të informimit publik për të gjitha operacionet zgjedhore, veçmas për hapat në vend votim, dhe për mënyrën e plotësimit të fletëvotimit...E dimë që ka një shqetësim të gjerë public për numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme, dhe e dimë që ky fenomen për zgjedhjet locale nxitet që të jetë masiv...Rrjedhimisht, se ne duhet të jemi të shqetësuar për epilogun e këtij procesi, mbi të gjitha nëse ne do t'i kemi mbi 100.000 fletëvotimet të pavlefshme, dhe po u ndjek ku ritëm do të mundë të befasoheni me shifrën edhe më të lartë të fletëvotimit të pavlefshme, dhe ne sigurisht që do t'i diskutojmë dhe do ti adresojmë problemet edhe këtu brenda, e edhe jashtë për shkakun se duhet me kohë të dihet përgjegjësia, në këtë rast veç e veç, por edhe për institucione siç është OSHP që e ka zhagitë, dhe ka shkaktue pengesa duke e rikthye disa herë procesin e vlerësimit dhe të rivlerësimit...Mirë është që Sekretariati po përpiqet për permisimit e imazhit, dhe po bënë përpekje për të gjitha këto aktivitete, mirë është që kanë vendos kontakte me shoqërinë civile, mirë është që për mënyrën e bashkëpunimit me subjektet politike dhe subjekte dhe ju kanë dërguar një tekst se si plotësohet fletëvotim e tjera..., mbase edhe duke i nxitur edhe subjektet qeveritare për me kërkue përkrahjen e tyre në këtë vakum, gjithnjë duke mos e dëmtuar procesin...

Unë, tha z. Rrustemi, personalisht ju bëj thirrje OJQ-ve të cilat janë të involvuarë në këtë proces zgjedhorë, megjithse kanë qenë të përqendruar në mbarvajtje të integritetit, le të përfshihen edhe në edukimin e votuesëve në aspektin e plotësimit të fletvotimeve. E kam thanë edhe ma herët, se mendoj që jemi në një situatë që duhet me ndërmarrë vendime konkrete alternative. E para, kam kërkuar vazhdimisht me pa mundësin e modifikimit të spoteve nga zgjedhjet e 2013 se, sistemi zgjedhor nuk ka ndryshuar, procesi i votimit është i njëjtë neve dhe ne na duhet me e pa të drejtën e autorit me ndërhyrje, me u sqarue se a janë spotet pronsi e KQZ-së,,dhe nëse po, duhet me ndërhye veç te data e zgjedhjeve, dhe duhet të fillojnë të transmetohen në televizione publike ku e kemi pa pagesë hapsirën. S'kemi pse me pritë! Ne, po ju ofrohemi ditëve të zgjedhjeve dhe nuk ka asnjë lëvizje në këtë drejtim. Nëse na thutet se, nuk kemi të drejtë në ndërhyrje në videospote, mendoj që zyrtarët komunal dhe komisionet komunale zgjedhore duhet me i përfshi edhe në mënyrë më aktive, çka nënkupton përveq këtyreve aktiviteteve që janë goxha sipërfaqësore, ne duhet me vendos tenda, kabina nëpër qendra, nëpër komuna ku e shpjegojnë procesin e votimit.

Ne, tha z. Rrustemi, kemi trajner me numër goxha të madhë nëpër nivele komune, kemi antarë të KKZ-ve, le të fillojnë me edukimin e drejtëpërdrejtë të votuesëve duke e demonstru procesin e votimit me shpresë që ata që e bëjnë këtë aktivitet, kanë me e shpërnda edhe tek familjet e tyre, tek miqët etj. Le të fillojnë edhe ndonjë aktivitet në shkolla, një ligjeratë të shkurtër, me maturanët të cilët kanë të drejtë vote. Le ta elaburojnë shkurtimishtë veq procesin e votimit nuk po flasim kësaj here për rendsin e pjesmarrjes në zgjedhje, d.m.th., se, nuk mundemi me vazhduar në këtë mënyrë. E kam hallin që shpërndarja e fletëushkës në ditën e zgjedhjeve, nuk ka me mbërri rezultate, me mbërri efektin se si votuesi perballtet me votimin. Atë ditë, votuesi e ka të

pamundur si me thane, me e absorbue informacionin nuk po thomë që kom e i ndihmu ose me ja letësu po nuk është e sigurtë.

Një çështje tjetër, është edhe ideja për stimulimin e zgjedhjeve në 6 universitete. Personalisht, kisha pas dëshirë me pasë informacion me të shtuar ( jo në këtë mbledhje) nga përgjegjësit dhe me na tregu për qëllimet dhe funksionet, edhe me na informue për rezultatet që i nxjerrin nga simulimi. Me sa po e kuptoj, në një far mënyre eksperimentim i procesit të votimit, jo veq për mënyrën e votimit por edhe për mënyrën e procesimit të komisionerëve, procesi i përmbylljes së rezultateve e kështu me radhë, mbase kemi ba edhe testimin e formularit të ri për rezultatin..., e gjitha na duhet me pa qysh ka me qenë reagimi. Edhe e treat, e kam një çështje që më duhet me ngritë ma teper për me kërkuar prej Sekretariatit që me i njoftuar komisionet komunale në mënyrë sa më adekuate, në një nga qendrat në Kosovë: një tubim elektorale në këtë rast si për Lëvizjen Vetvendosje, është dështuar për shkak se drejtori i shkollës nuk i ka hapur dyret e shkollës me arsytimin se, nuk është marrë leje nga drejtoria komunale e arsimit! Ne, të gjithë e dimë që, përkundër qysh ka qenë i paralelmëruar në mënyrë të rregullt në KKZ dhe në polici, ne të gjithë e dimë që e kemi një memorandum bashkpunimi me ministrinë e arsimit ku shkollat vihen në dispozicion të subjekteve politike, jashta orarit mësimor për me i shfrytëzuar takimet e para lektorale. Veç, po kërkuj nga Sekretariatit me ia dërguar një shkresë, duke iu referuar këtij memorandumit dhe kësaj dispozite, të secilën KKZ ua përcjell edhe drejtorive komunale të arsimit që, nuk është e domosdoshme, e as që kërkohet me marrë leje nga DKA, në këtë rast për secilën shkollë, për secilin tubim se kështu krijojmë edhe standare të dyfishta për subjekte të caktuara por, edhe e bëjmë të pamundur procesin d.m.th., mundet që KKZ, eventualisht me e njoftuar drejtorinë lokale të arsimit me krejt planin e aktiviteteve, por nuk është që kërkohet për çdo aktivitet, për çdo ditë për me kërkuar leje nga DKA...

### **3. Aktivitetet e ZRPP-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i akreditimit të vëzhguesve për zgjedhjet lokale 2017*

**Miradie Mavriqi:** Faliminderit...Zyra ka pregaditur për akreditimin e vëzhguesëve dy rekomandime, ngase njëri është dorzuar më 25, kurse tjetri më 27 dhe se kanë të bëjnë me procesin e vëzhguesëve...,duke u bazuar në nenin 54 të paragrafit 1 për Ligjin për Zgjedhjet të nenit 19, të Ligjit dhe për Zgjedhjet Lokale, dhe nenit 3 dhe numër 07/2013 për Zëzhguesit e Zgjedhjeve sikurse, duke u bazuar në planin operacional...Deri me 25 shtator, gjegjësisht deri me 26 shtator, zyra ka procesuar edhe rekomandimin e 15 organizatave vëzhguese, njëkohësisht edhe me 1310 vëzhgues. I kemi të listuara në rekomandimin e parë, ndërsa në rekomandimin tjetër, i kemi 25 organizata me gjithsej 17.440 vëzhgues. Gjithashtut, listat e organizatave i keni të bashkangjitur, ndërsa po ju informoj se emrat e vëzhguesit janë të bashkangjitur në rekomandime...

**Valdete Daka:** I kemi dy rekomandime: Rekomandimi i pare, ka të bëjë me 4310 vëzhgues. Kush është pra që të akreditohen ky numër....?

*Anëtarët e KQZ-së, akredituan këta vëzhgues.*

**Valdete Daka:** Ndërkaq, rekomandimi i dytë, ka të bëjë me 17444 vëzhgues, emrat e të cilëve i keni në CD. Kush është për....?

*Anëtarët e KQZ-së, akredituan edhe këta vëzhgues. Gjithsej: 21754 vëzhgues.*

#### **4. Raport i Këshillave**

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

*1. Shqyrtimi dhe miratimi i mostrave të fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme për Zgjedhjet Lokale 2017*

**Adnan Rrustemi:** Ngase, nuk na erdh ende materiali për këshillat e vendvotimeve, unë po filloj për njoftimin për mostrat e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Siç e dini, edhe në mbledhjen e kaluar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ne, e kemi shqyrtuar dhe miratuar Dracakun për trajnimin e Këshillave të Vendvotimeve, e ku kanë qenë të integruara disa prej shembujve të fletëvotimeve të vlefshme, por edhe të pavlefshme si për kryetar komune ashtu edhe për kuvendet komunale. Ndërkohë, në të njëjtën mbledhje, kemi vërejtur disa vlerësime të pasakta të këtyre mostrave, dhe kemi kërku që doracaku të miratohet pa këta shembuj. Në mbledhjen e sotme të këshillit të operacioneve zgjedhore, ne kemi shqyrtuar shembuj që na janaë prezantuar dhe si të tilla, i kemi miratu d.m.th., jemi munduar që në përputhje me dispozitën e ligjit kur thotë që “fletëvotim i vlefshëm konsiderohet secili fletëvotim që e bënë të qartë qëllimin e votuesit”, natyrisht që kjo nuk është gjithmonë në mënyrë të njëjtë: diku votohet brenda kuadrantit, e diku nënvizohet komplet emri i subjektit politik, diku i rrumbullaksohet vetëm numëri e kështu me rradhë. Janë edhe shembujt të cilat e bëjnë më të thjeshtë vlersimin e fletëvotimit në këshillat e vendvotimit, për qka konsiderohet fletëvotimi i pavlefshëm.

Unë, vlerësoi z. Rrustemi, as nuk po i prezantoj një për një, mund t'i pranoni materialet kështu për nevoja personale që të kemi të qartë por, jemi mundur që të miratojmë vetëm shembujt që janë vetëm qartësisht të vlefshme ose të pavlefshme dhe mos të dërgojmë që mos ti përfshijmë në doracak shembujt të cilët mund të krijojnë më shumë konfuzitet dhe paqartësi e diskutime brenda komisionerëve dhe që janë të rralla ose fare të hasura në procesin e votimit. Kjo, është sa i përketë kësaj qështje por, edhe mund edhe të diskutojnë të tjerët nëse kanë rreth kësaj qështje.

**Betim Gjoshi:** Unë, pajtohem plotësisht me atë që u tha. Ne në punën tonë, jemi referuar në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe në ligjin për zgjedhjet lokale ku jepet përparsi qëllimit të votuesit. Pra, ashtu kemi shkuar edhe të shembujt e fletëvotimit në çdo rast kur shihet qartë qëllimi i votuesit atëherë e kemi konsideru fletëvotim të vlefshëm. Fletëvotime të pavlefshme, konsiderohen vetëm kur qytetarët nuk kanë votuar fare te subjektet politike dhe në rastet kur kanë votuar më shumë se sa një subjekt politik. Gjithashtu, të pjesa e kandidatëve nëse votuesi voton më shumë se një votues atëherë konsiderohet i pavlefshëm vetëm sa i përketë kandidatëve për subjektet politike parap është i vlefshëm këto kanë qenë shembujt që i përshkruajnë këto situata, mendoj që kjo i ka kontribu shumë edhe do të kontribuoj pjesës së

trajnimin edhe pjesës së punës së këshillave të vendvotimit dhe tashme pjesë të doracakut do ti kenë mostrat e fletëvotimeve. Jo që se kemi bërë në të kaluarën por, tash kanë shumë më shumë lloj shembuj edhe mendoj që kjo do të kontribuoj edhe vlersimit të saktë fletëvotimit të vlefshëm të pavlefshme që të që nga njëherë kemi pasur kësi far probleme gjatë renumërimit në qendër të rinumërimit edhe vëzhguesit edhe të tjerët kanë mundur të vërejnë raste kur ka qnë vështirë të përcaktohet a është i vlefshëm apo i pavlefshëm.

Ne kësaj radhe, tha z. Gjoshi, kemi marrë një grumbull shembujsh që do të ju shërbejnë dhe që kanë shkuar në favor të asaj që parashihet edhe me ligj, që parashihet vullneti i votuesve apo qëllimin e votuesve, dhe mendoj që janë në rregull...

**Valdete Daka:** Faleminderit. Kush është për miratimin e këtyre mostrave?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan mostrat e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme për Zgjedhjet Lokale 2017*

## 2. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit të ballinës së Ueb Faqes së KQZ-së

**Adnan Rrustemi:** Po vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e dizajnit të ballinës së ueb faqes së KQZ-ës. Ju, e keni para vetës një material të përgatitur nga sekretariati natyrisht edhe me mbështetjen e IFES-it që në fakt është diskutuar edhe me ater tjerë. është një propozim nga sekretariati që është diskutu dhe është shqyrtuar në këshillin operacioneve zgjedhore dhe si i tillë i rekomandohet KQZ-ës, bëhet fjalë për dizajnin e ballinës ueb faqes së KQZ-ës që do të plotësohet natyrisht me përmbajtje dhe do të bëhet funksionale vonë. Mos u përqendroni në përmbajtje vetëm në aspektin vizual dhe të dizajnit, ne e kemi miratuar si të tillë d.m.th. e bënë komplet ueb faqen e KQZ-ës më të qasshme më të përdorshme dhe në funksion dhe në shërbim të informimit më të qartë dhe më të thjeshtë edhe të votuesve edhe të akterëve tjerë,do të ketë d.m.th. pjesën qendrore lartë ballina e KQZ-ës pastaj informacionet e caktuara për ngjarjet që zhvillohen, lartë do të jenë këto rubrikat kryesore rreth KQZ-ës, zgjedhjet, legjislacioni ngjarje dhe njoftime, shërbimi i votuesve dhe publikime. U bë një propozim me të drejtë me vendos një rubrikë për aktivitetin në fokus d.m.th. për ngjarjen ose operacionin qendror që zhvillohet aktualisht. Shiriti lartë do të ketë informacione në lëvizje informacionet aktuale që kanë të bëjnë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në ndërkohë pjesa tjetër e operacioneve zgjedhore, përqëndrohet te shërbimi votues dhe shërbimi i subjekteve politike dhe shërbimi për OJQ-ët dhe medie dhe pjesa tjetër ndryshimet e fundit. Pjesa e fundit nëpërmjet kutive të caktuara, i përqëndrohet aktiviteteve më të rëndësishme në kohë, fletëvotimeve po e zë vetëm shembull zyra e partive politike vendimet e KQZ-ës, pyetjet më të shpeshta, informata zgjedhore rreth komunës tuaj, lidhje direkte, edukimi dhe informimi votuesve merr një hapsirë më të madhe dhe ngjarjet e ardhme që janë në fund, kalendari i aktiviteteve të KQZ-ës, mbledhjet e KQZ-ës sikurse edhe lidhja direkte me faqen e KQZ-ës në facebook për të qenë si me thënë procesi i përplotësimit me informacione. Nëse nuk keni ndonjë sugjerim sa i përket dizajnit, gjithmonë jo përmbajtjes, mund ta jepni por, KOZ-i rekomandon miratimin e këtij dizajni.

**Valdete Daka:** Falemnderit. A ka dikush të shtojë diçka më shumë...?

**Betim Gjoshi:** Ne, e dimë që 5-6 vitet e para të funksionimit të KQZ-së, kemi pasur mjaft problem në Ueb faqen e KQZ-së. Në 2012, nëse nuk gabohem, kemi krijuar një dizajn të ri të ueb faqes i cili, për kohën ka qenë shumë i avansuar. Ne e dimë në bazë të zgjedhjeve se, shpeshherë ueb faqja jonë ka qenë më e klikuara, sidomos gjatë ditës së zgjedhjeve në Kosovë, dhe ka tejkaluar mediat e ndryshme...Mendoj që, edhe mjetet e komunikimit e kanë ndërru formën dhe mënyrat e komunikimit janë bërë jashtëzakonisht të rëndësishme...Unë, e kam potencuar shumë herë gjatë mbledhjeve këtu se, Komisioni Zgjedhor duhet që votuesit t'i furnizojë me burime dhe shërbime përmes ueb faqes sonë dhe se, një dizajn i ri do të duhej të ishte më i avancuar, krahasuar me të kaluarën...

**Valdete Daka:** Falemnderit Betim...! Kush është pra këtë propozim, për këtë dizajn me shirit...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan dizajnin e ballinës së Ueb Faqes së KQZ-së.*

### 3. Plotësimi i grupit punues për ridizajnimin e Ueb Faqes së KQZ-së me anëtarë të KQZ-së

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me pikën tjetër...

**Adnan Rrustemi:** Po, pika tjetër ndërlihet po ashtu me pikën paraprake, siç u tha Sekretariati ka zhvilluar një projekt do të thoja unë, në këtë aspektin e ridizajnit dhe zhvillimit të ueb faqes së KQZ-së. Deri më tani, ka realizuar aktivitetet në mënyrë profesionale në bashkëpunim me IFES-in dhe konsultim të gjerë, tani në pikën që ka mbërri që bëhet fjalë më shumë për aspektin përmbajtësor të ueb faqes edhe ndërhyrjes në rubrika kanë sjellë një kërkesë një propozim që grupit punues aktual ti bashkëngjiten edhe disa anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas vlerësimeve të tyre është dëshmuar edhe në të kaluarën që ka qenë kontribut i shtuar në këtë aspekt. KOZ-i, tha z. Rrustemi, i ka bërë tre propozime për tre anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që mund të kontribuojnë në këtë komision që deri në dhjetor ta përmbyllim këtë proces që në janar të lansohet ueb faqja e ri dizajnuar dhe e zhvilluar rishtaz. Propozimi është që të jetë: Betim Gjoshi, Bajram Latifi, dhe unë, Adnan Rrustemi. Nëse nëse nuk ka vërejtje nga KQZ-ja, rekomandimi ynë është për miratim...

**Valdete Daka:** Jo, besoj nuk ka ka vërejtje. Kush është për miratim...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e KOZ-it për ridizajnimin e Ueb Faqes së KQZ-së me anëtarë të KQZ-së*

### 4. Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së emërimeve për Këshillat e Vendvotimeve sipas komunave përkatëse për Zgjedhjet Lokale 2017



**Valdete Daka:** Vazhdojmë...!

**Adnan Rrustemi:** Ne, ende po e presim materialin, mirëpo ne vazhdojmë sepse, është edhe një nënpikë tjetër që, janë dy anëtarë të KKZ-ve në dy zëvendësime, po më vjen keq që nuk e kanë sjellë materialin por, mbase mund ta shqyrtojmë në pjesën tjetër kur ta na sjellin materialein...

**Betim Gjoshi:** Kryetare, ndoshta vetëm nja dy fjalë para se me shkue në një pauzë, deri sa të shtypet materiali...Është ndoshta mirë me i kërkuar ndjesë medias se për arsye se materiali nuk na ka ardhur me kohë...por, fjala është për mijëra komisioner për të cilët cilët, është duke u shtyrë materiali...Unë, dëshiroj të them se në përgjithësi, ne e kemi diskutuar sot çështjen e KVV-e, dhe se unë i përgëzoj të gjithë anëtarët e KOZ-it kan kontribuar në krijimin e këshillave të vendotimit që ato, të jenë sa më gjithëpërfshirëse gjë që, edhe e garantojnë një proces më të denjë të zgjedhorë. Ne, besoj që kemi m'i pa komunë për komunë por, mendoj se është bërë jashtëzakonisht një punë e mirë qysh është bërë edhe në të kaluarën rreth themelimit të trupave zgjedhore, dhe ndoshta si komision, si trupë zgjedhore edhe jemi shembull për institucionet e tjera për punën e mirë që e kemi bërë bashkarisht...

**Valdete Daka:** Adnan vazhdojme me zëvendësimet së pari...!

**Adnan Rrustemi:** Këshilli i operacioneve, ka shqyrtuar dy kërkesa për dy zëvendësime, respektivisht në komunën e Malishevës dhe të Vushtrrisë...Tërhiqet kandidati i parë i subjektit politik, në këtë rast i LDK-së në komunën e Malishevës, dhe emërohet anëtari i dytë zëvendësues, në këtë rast si anëtar nga subjekti politik Nisma në Vushtrri. Kështu që, rekomandojmë KQZ-në sado me vonesë, ti miratoj këto zëvendësime...

**Valdete Daka:** Faleminderit. Kush është për?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimet KOZ-it lidhur me dy zëvendësime*

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me KVV-të, sipas komunave. A ka nevojë komunë për komunë t'i shiqojmë? Këto janë rekomandimet, ky material është rekomandim i KOZ-it.

**Adnan Rrustemi:** Materiali, është rekomandim i Këshillit Operacioneve Zgjedhore. Pas shqyrtimit që është bërë, ne rekomadojmë KQZ-në që si të tillë ti miratoj, dhe ti emëroj këshillet e vendotimit. Natyrisht që sot, po vendosim për përbërjen e KVV-ve respektivisht, për formulën, dhe jo për emrat e përvetshëm. Por, Sekretariti duhet të na ofroj në dispozicion emrat e secilit këshill të vendotimit për secilën komunë, dhe secilin subjekt politik. Natyrisht që ne, jemi munduar me e respektuar dispozitat ligjore për përbërjen por, edhe duke i marr parasysht edhe për secilën komunë natyrisht sepse, përbërja dallon në varësi të komunës...Pra, jo në secilën komunë është përbërja e njëjtë, sikurse edhe ligji e ka këtë frymë. Ne, kemi dy mundësi: me marr vendim të përgjithshëm për emërimin e Këshilleve të Vendotimeve, por duke përcaktuar në të njëjtin vendim që përbërja e Këshilleve të Vendotimeve është e ndryshme për secilën komunë dhe reflekton tabelat që i bashkëngjiten këtij vendimi, ose me marrë një vendim për secilën komunë veç e veç. Por, nëse merret vendimi i parë, unë propozoj që ta ketë një si pjesë të arsytimit ose diapozitivit që e përcaton qartë se përbërja e KKZ-ve për secilën komunë është e

ndryshme në varësi të rrethanave dhe të rezultatit, dhe që përbërja i referohet tabelave të bashkangjitura këtij raporti...

**Valdete Daka:** Natyrisht që nuk përmban kurëfarë dallimi, dhe nëse doni mundemi ta votojmë kështu, në bllok, për gjitha komunat edhe pastaj, të gjitha këto tabela t'ia bashkangjesim pastaj vendimit...

**Betim Gjoshi:** Unë mendoj që është bërë një punë e madhe, është me rëndësi shumë që Sekretariati i KQZ-së të paktën deri të dielen në mbrëmje, të na dërgoj emrat e përveqshëm të këtyre personave në bazë të kësaj formule. Është me rëndësi që asnjë zëvendësim i tyre, mos të bëhet pa marrë miratimin e KQZ-së. Po ashtu, është me rëndësi shumë të kuptohet se në një pjesë mungojnë rezervat, e që rezervat t'ju kërkohen subjekteve politike t'i sjellin në bazë të 10% që ju takon për arsye se, ne mund të kemi mungesa ditën e zgjedhjeve, dhe mos të dërgojmë njerëz të pa trajnuar... Është me rëndësi që të përgatitet vendimi për secilën komunë, teksti siç e përcaktuan kolegët. Është shumë me rëndësi që merret për bazë edhe pjesa e ligjit, neni 77.4 në preambulë po ju kujtoj edhe një here nuk e di kush e pat draftvendimin, neni 77.4 ku thotë pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, nëse kërkohet KQZ-ja kompetencë për të emëruar sipas zgjedhjeve të saj anëtarët e KVV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni. Kjo ka të bëjë sidomos se ne ju kemi dhënë përparësi disa kandidatëve të pavarur e disa iniciativave të reja se kemi dashur që këshillet e vendotimeve me qenë me gjithpërfshirje edhe kjo e jep argumentin e saj.

Unë, tha z. Gjoshi, gjithmonë kam kërkuar dhe jam mbështetës edhe për këtë e thash në pjesën e parë se, i falënderoj kolegët se kanë dhënë të gjithë prej vetes për të mbërritur deri te kjo zgjidhje, dhe se mendoj që është bërë zgjidhja më e mirë e mundshme që garanton një gjithpërfshirje... Unë prita prej kolegëve, por ndoshta kanë me thënë më vonë që ne si Këshill i Operacioneve Zgjedhore, kemi bërë sot edhe një rekomandim sa i përket raundit të dytë, që kryesuesit e këshillave të vendotimit të ndahen të barabartë mes dy personave që janë në garë në raundin e dytë. Kjo, është e rëndësishme dhe i ndihmon kritibilitetit edhe pjesëmarrsve së kryesuesve të këshillave në vendotim. Deri te ky koncensus, kemi mbërritur duke pas për bazë edhe raundin e dytë. Kjo, është jashtëzakonisht e rëndësishme. Këshillat, mbesin të njëjta por vetëm kryesuesit ndahen të barabartë mes dy kandidatëve që janë në garë në raundin e dytë, me qëllim që mos me na krijuar probleme...

**Valdete Daka:** Në rregull. Kush është për këtë rekomandim të KOZ-it, për këshillat e vendotimeve sipas këtyre tabelave! Me një vendim. Ndërsa këto tabela do të jenë pjesë përbërse e vendimit. Kush është për pra...? Ndërkaq, çështje e dytë është që kryesuesit në raundin e dytë, të ndahen në mes dy subjekteve politike të cilat janë në garë. Përbërja e këshillave mbetet e njëjta, përveq kryesuesve të cilët pra i ndajnë në mënyrë të barabartë në mes tyre dy subjektet politike, apo edhe e kandidatëve....

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan përbërjen e Këshillave të Vendotimeve (KVV) sipas komunave përkatëse për Zgjedhjet Lokale 2017 dhe që kryesuesit në raundin e dytë, të ndahen në mes dy subjekteve politike apo edhe e dy kandidatëve të cilat janë në garë, ndërsa përbërja e këshillave mbetet e njëjtë.*

**Adnan Rrustemi:** Shkurtë sa i përket komisionerëve. Duke i`u referuar edhe praktikave të mëhershme por edhe për ta siguruar integritetin për të mos nxitur diskutime, Sekretariati duhet me na përgatit edhe një udhëzim të ndarjes së pozicioneve brenda këshilleve të vendvotimeve në mënyrë të atillë që e kemi bërë tash si praktikë, e që ndahet në mënyrë proporcionale secili pozicion, anëtari i dytë merrë pozicionin e ndihmësit të zyrtarit identifikues, dhe atij që shpërndan fletëvotimet me qëllim që të sigurohet një lloj transparence...

**Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----